

Aktiviteti: Ditët e informimit të maturantëve

Data: 18.02.2020 - 22.02.2020

Vendi: Qendra Rinore Ten, Tiranë

Qëllimi: Njohja, informimi dhe këshillimi i nxënësve maturantë për IAL dhe programet e studimit të ciklit të parë dhe programeve të integruara të ciklit të dytë.

Ditët e informimit të maturantëve u zhvilluan nga data 18.02.2020 - 22.02.2020, në mjediset e Qendrës Rinore Ten, Tiranë.

Pjesëmarrësit: Universitete nga i gjithë vendi, maturantë nga shkolla të mesme publike dhe jopublike të Tiranës

Për pesë ditë me radhë Universitete nga gjithë vendi informuan maturantët e gjimnazeve të ndryshme në Tiranë, me programet e studimit, mundësitë e zhvillimit të karrierës, me stafet pedagogjike dhe gjithçka tjetër që iu duhet, për të bërë një zgjedhje të preferuar bazuar mbi njohuritë, dëshirën, interesin personal dhe mundësitë e punësimit dhe progresit. Në këtë aktivitet u përfshi **Zyra e Karrierës** së Universitetit Politeknik të Tiranës, Drejtorja e Kurrikulës dhe përfaqësues të stafit pedagogjik të çdo Fakulteti të Universitetit Politeknik të Tiranës. Për këtë panair u përdorën **(Baner, guida, broshura, fletëpalosje informuese).**

<http://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1069-njoftim-ditet-e-informimit-te-maturanteve>